



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr \_\_\_\_\_ prot,

Tiranë, më 07.11.2023

Lënda: Kërkesë për interpretancë urgjente me Kryeministrin Edi Rama.

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla  
Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore: Neni 80, pika 1 të Kushtetutës  
Neni 96 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit

E Nderuar Znj. Nikolla.

Me datë 06 Nëntor 2023 nëpërmjet një konference të transmetuar drejtpërdrejt nga media jemi njohur me faktin se Shqipëria, e përfaqësuar nga Kryeministri, nënshkroi një marrëveshje ne Italianë për emigrantët.

Në baze të deklaratave publike për objektin e marrëveshjes rezulton se Shqipëria do të kthehet në një bazë, (mediat informojnë për dy kampe të mëdha me kapacitet jo më pak se 3.000 persona) ku do të strehohen emigrante nga Afrika Veriore të mbërritur në mënyrë të paligjshme në kufirin jugor të Italisë.

Marreveshja e nënshkruar sot duket se është diskutuar mes dy kryeministrave, italian dhe shqiptar, për një kohë të gjatë.

Çështja e emigrantëve është prej kohësh shqetësim për vendin fqinj dhe po ashtu është çështje debati politik jo vetëm në Itali, por edhe në vende të tjera të Bashkimit European

Çështja e emigrantëve sjell shqetësime të mëdha për çdo vend antar të Bashkimit European, jo vetëm për përballimin e situatës humanitare por edhe të sigurisë kombëtare të secikut prej tyre.

Siç është bërë e ditur në Portin e Shëngjinit do të ngrihet qendra për pritjen e refugjatëve që do të jetë nën juridiksionin e Italisë, dhe një tjetër strukturë do të ngrihet në Gjadër për akomodimin e tyre. Kjo qendër parashikohet që të jetë gati në pranverën e ardhshme, pikërisht kur nis dhe sezoni turistik

Ky lajm vjen si surprizë në Shqipëri, pasi nuk ka pasur asnjë debat politik apo publik për një çështje kaq sensitive për qytetarët dhe për mbarë vëndin

Me te drejte opinioni publik është i shqetësuar pasi flukse të tilla njerëzore sjellin në mënyrë të llogjikshme lëvizje të ekuilibrave social dhe ekonomik të zonave ku këta refugjate do të vendosen. Po ashtu krijon pasiguri në kapacitetet e qeverisë shqiptare për të përballuar këtë fenomen pa krijuar probleme të sigurisë, stabilitetit ekonomik apo social të brendshëm.

Për sa më lartë me qëllim marrjen e informacioneve dhe për të bërë transparencë, përpara qytetarëve shqiptarë të arsyeve që kanë çuar Kryeministrin e Shqipërisë në këtë vetëofrim, pa asnjë konsultim publik, kur vendet europiane e kanë refuzuar atë, pavarësisht kapaciteteve për të menaxhuar këtë fluks emigrantësh, në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 96 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj zhvillimin e një interpelancë urgjente me Kryeministrin Edi Rama.

Deputeti

Kreshnik Çollaku